

REPUBLIKA E KOSOVËS  
 VENDIMI ËSHTË I PLOTËFQUISHËM  
 GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - PRIRËNË  
 16.01.2017 18

P.nr.1928/2017

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti i Përgjithshëm  
 Gjyqtari i vetëm gjykues Vjollca Buzhala, me sekretarën juridike Drita Baftjari, në  
 lëndës penale kundër të akuzuarit M. M nga fshati L. , Komuna  
 Prizren, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 parag. 1 pika  
 1.4 të Kodit Penal, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në  
 Prizren PP.nr.2418-1/17 të dt.12.10.2017, për dhënien e urdhërit ndëshkimor,  
 gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 15.11.2017, mori këtë:

**AKT GJYKIM**

**I akuzuari:**

M. M., nga i ati L. dhe e ëma R. -e lindur Th. i lindur me  
 në fshatin L., Komuna Prizren, ku edhe tani jeton, ka të kryer  
 shkollën e mesme, beqar, i gjendjes së mesme ekonomike, puntor krahu ,shqiptar,  
 shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTORË**

Se me datë 16.08.2017, rreth orës 14:20, në fshatin L., Komuna Prizren  
 ,saktësisht perball market " L. ", duke mos iu përmbajtur dispozitave të  
 komunikacionit në rrugë ,shkel Ligjin mbi Trafikun Publik , rrezikon trafikun publik ,  
 rrezikon jetën e njerëzve dhe pasurinë ,vepron në kundërshtim me nenin 42 të Ligjit për  
 Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, në atë mënyrë që i pandehuri , duke drejtuar  
 automjetin e llojit kombi, të markës " Mercedes 601 " me shenjen regjistruar  
 i cili nuk leviz me kujdes të shtuar gjatë tentimit ,procesit të kyqjes nga hapsira e qendres  
 tregtare " L. " në rrugën kryesore ,po ashtu nuk i jep perparsi kalimi vetures " Mercedes - R 320 " me shenjen regjistruar i cili ishte duke levizur në  
 shiritin e duhur,ne pamundesë që të ndalojë nga distanca e shkurter që i kishte dalur para  
 automjeti i llojit kombi, të markës " Mercedes 601 " e godet me pjesën e perparme  
 ,perpos demëve materiale lëndime të lehta trupore pesojn të demtuarit , N. E.  
 N. K. dhe M. Sh. , lëndime këto të konstatuara në konkluzionin e  
 ekspertit mjeko -ligjor dr. N. H. të dt. 26.09.2017.


**Me këto veprime ka kryer veprën penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag. 6 lidhur me parag.1 të KP-së .**

Andaj gjykata pas vlersimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 493 dhe 495 të KPP-së jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**PRANOHET KËRKESA** e Prokurorisë Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhërit ndëshkimor, PP/II.nr.2418-1/2017 të dt. 12.10.2017.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4,41,43 par.1 nën par.1.3, nenit 46/73 , 378 parag. 6 lidhur me parag.1 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së të akuzuarit ia shqipton:



### DENIMIN ME GJOBË

Ashtu që gjykata të akuzuarit mensur maqkaj ia cakton dënimin me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësoje në dënim me burg, konform nenit 46 parag. 4 të KP-së.

Të dëmtuarit N. E. me adres banimi ne rr " " pa nr, N. K. me adres banimi ne Prizren dhe M. Sh. me adres banimi ne fshatin K. -H. KK Prizren , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civilë.


I akuzuari obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sa do që të jenë ato, sipas llogarise se bërë në arkën e kësaj gjykate si dhe paushallin gjyqësore në shumën prej 30 €, shumën prej 20.44 € në emër të ekspertizës mjeko ligjore për të dëmtuarën dhe në emër të ekspertizës së ekspertit të komunikacionit shumën prej 40.88 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshem, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 2418-1/2017 të dt.12.10.2017, kundër të akuzuarit M. M. nga fshati L., Komuna Pizren, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag. 6 lidhur me parag.1 të KP-së ,të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të akuzuarit do ti shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të besueshme se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Dhe konform nenit 493 te KPP-së, kërkoi që gjykata pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor te jep **URDHËRIN NDËSHKIMOR** me te cilin të akuzuarit do ti shqiptohet dënimi me gjobë.

Pas shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 parag.1 të KPP-së, dhe në kuptim të nenit 495 parag.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë - nga shikimi i kallximit penal të paraqitur nga Policija e Kosovës , Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në prizren , me nr 2017- GR -0635 ,të dt.16.08.2017 ,raportin fillestar teincidentit te dt.16.08.2017 ,raportin e oficerit të dt 16.08.2017 ,ne procesverbalin mbi intervistimit te te dyshuarit,ne deklaratat e te demtuarve, ne raportin mjeksor te leshuar nga emergjenca e spitalit regional në Prizren,me te protokolit , 9495 ,9492,9494 ,9493 te dt 16.08.2017 , ne fotodokumentacion ne ekspertizen e ekspertit të komunikacionit nga eksperti M. D. e datës 22.09.2017 dhe konkluzioni i ekspertit mjeko-ligjor nga Dr. N. H. të dt. 26.09.2017



Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike ne kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 450 dhe 451 parag.1 dhe 2 të KPP-së.

Me sa u tha me larte, ne kuptim te nenit 495 parag.2 lidhur me parag.1 të KPP-së, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,**  
P.nr.1928/2017, me datë 15.11.2017

Sekretarja juridike,  
Drita Baftjari  
*[Signature]*



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në këtë gjykatë. Po që se i akuzuari nuk paraqet kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formen e prerë.